FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.36 18 prill 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7334 datë 12.3.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	1689
Dekret nr. 7335 datë 12.3.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1690
Dekret nr. 7337 datë 19.3.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1690
Vendim i KM nr. 245, datë 4.4.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH, sh.a.", të ndryshuar.....	1691
Udhëzim i MF nr. 7/1, datë 29.2.2012	Për përgatitjen e buxhetit vendor	1694
Udhëzim i i MBUMK nr. 5, datë 16.2.2012	Për sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar, si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkëses për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar	1698
Urdhër i MBUMK nr. 42, datë 16.2.2012	Për speciet e bimëve, varieteti i të cilave duhet të regjistrohet në Katalogun Kombëtar	1706
Vendim i GJK nr. 18, datë 2.4.2012	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 67, datë 2.5.2001 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2011-437 (66), datë 28.4.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	1710

Vendim i GJK nr. 19, datë 2.4.2012	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 26, datë 1.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të vendimit nr. 173, datë 18.5.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 588, datë 19.12.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.	1715
Vendim i ERE nr. 16, datë 17.2.2012	Mbi kapacitetet e interkonjeksioneve në drejtimin import-eksport për muajin mars 2012.....	1721
Vendim i ERE nr. 27, datë 15.3.2012	Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike me nr. 952 prot., datë 23.2.2012 midis OST sh.a. dhe GSA sh.p.k.....	1722
Vendim i ERE nr. 28, datë 15.3.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec–et "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3"	1723
Vendim i ERE nr. 29, datë 15.3.2012	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s "Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtarisë së ERE-s gjatë vitit 2011".....	1724

DEKRET
Nr. 7334, datë 12.3.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Oerda Çaush Kokthi (Topalli)
2. Silvio Gentian Kokthi
3. Denisa Daut Albesi
4. Lulëzim Bashkim Çelepija
5. Orjola Ahmet Fortuzi
6. Jonida Abedin Hoxha
7. Ilir Shaqir Bardhi
8. Julinda Musli Bardhi (Ramadani)
9. Jon Ilir Bardhi
10. Rigers Ilir Bardhi
11. Madalena Ndoc Ndoja
12. Suela Sulo Hamza
13. Ilmi (Ilmi Valset) Hiqmet Ibraliu
14. Zorada Idriz Bajrami (Mulosmani)
15. Miranda Nebi Müller (Bani)
16. Julian Josif Prifti
17. Alketa Demirali Auer (Proga)
18. Silvana Shaban Ullini
19. Lulzim Shpëtim Rexha
20. Evis Urim Luga (Reci)
21. Adrian Perikli Nikolla
22. Daniela Koli Holl (Veshi)
23. Dorita Krenar Preza
24. Manjola Halim Syla (Seitaj)
25. Eugenio Artur Duka
26. Enkeleda Perparim Mulla-Steffmann (Mulla)
27. Xhoi Bledar Dragoj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7335, datë 12.3.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Shkelzen Sokol Jetishi
2. Laureta Gjevit Vezaj (Fanaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7337, datë 19.3.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:
1. Muharrem Tahir Lokaj
2. Abduraman Muharem Murati
3. Ismail Abduraiz Beqiri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.245, datë 4.4.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË PËR MAKINERITË DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGJINË ELEKTRIKE, TË IMPORTUAR NGA KESH, SHA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në seksionin I/I "Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për importin e makinerive e të pajisjeve, kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimi i ofrimit të prodhimit apo shërbimit është mbi 12 muaj", të vendimit nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalia e parë e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kur vërtetohet, pas verifikimit në vend të investimit dhe dokumentacionit, përputhja e kërkesës së personit të tatueshëm me situatën në fakt, drejtoria rajonale tatimore dërgon, zyrtarisht, sipas formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e protokollimit të kërkesës, në adresë të personit të tatueshëm, konfirmimin e faktit që produkti/shërbimi, për të cilin kryhet investimi, nuk është krijuar dhe as nuk është furnizuar nga personi i tatueshëm për vete apo për të tretë.".

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Personi i tatueshëm i paraqet Ministrit të Financave kërkesën me shkrim për shtyrjen e afatit të pagesës së TVSH-së, përtej dymbëdhjetë muajve, së bashku me:

a) përshkrimin e qartë të llojit të investimit që po kryhet, shpjegime të sakta për kohëzgjatjen e ciklit të investimit, vlerën e parashikuar të investimit etj;

b) përgjigjen e dhënë nga drejtoria rajonale tatimore (origjinale), sipas pikës 6 të këtij seksioni;

c) kopjen e kontratës/ave ose të marrëveshjes me zbatuesit e investimit, ku të jetë përcaktuar qartë afati i kryerjes së të gjithë ciklit të investimeve;

ç) parashikimin e afatit të fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit;

d) kopje të autorizimeve të lëshuara nga dega doganore që ka miratuar shtyrjen e pagesës së TVSH-së deri në dymbëdhjetë muaj;

dh) kopje të deklaratave doganore të importit.".

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Ministri i Financave, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e protokollimit të kërkesës, miraton ose jo zgjatjen e afatit të shtyrjes së pagesës së TVSH-së për subjektin e interesuar. Një

kopje e kërkesës së miratuar i dërgohet autoritetit doganor, me qëllim që subjekti të mos shpallet debitor, dhe organit tatimor, me qëllim regjistrimin e të dhënave të autorizimit në regjistrin e veçantë të personit të tatueshëm.".

4. Paragrafi i fundit i pikës 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Njëkohësisht, drejtoria doganore njofton, me shkrim, drejtoritë rajonale tatimore, ku është i regjistruar personi i tatueshëm, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për mbylljen e veprimeve të lidhura me TVSH-në, me këtë person.

Brenda datës 20 janar të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zyrtarisht, dërgon në Ministrinë e Financave listën me të gjitha të dhënat e nevojshme për të gjithë personat e tatueshëm, për të cilët është aplikuar skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së.".

5. Pas pikës 12, shtohen pikat 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.5, 12.6 dhe 12.7, me këtë përmbajtje:

"12.1. Në rast se tatimpaguesi në administratën tatimore rezulton me situatë kreditore të TVSH-së, e cila ka plotësuar kushtet ligjore për t'u rimbursuar, dhe, njëkohësisht, në administratën doganore me situatë debitore për TVSH-në e shtyrë në import me autorizim nga Ministri i Financave, bazuar në pikën 2.1 të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, atëherë ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku është i regjistruar, për destinimin e shumës së kërkuar për rimbursimin e TVSH-së për t'u kaluar te organi doganor për likuidimin e shumës së TVSH-së debitore që ka në administratën doganore. Bashkë me kërkesën, tatimpaguesi duhet të depozitojë dokumentet e mëposhtme:

a) Situatën e TVSH-së, që provon ekzistencën e tepricës kreditore të TVSH-së.

b) Një vërtetim të lëshuar nga kryetari i degës doganore kompetente, në të cilin është përcaktuar shuma e TVSH-së debitore, si dhe shënohet se ky vërtetim është lëshuar me kërkesë të tatimpaguesit për kompensimin e detyrimeve të TVSH-së si rezultat i zbatimit të skemës së shtyrjes së TVSH-së. Vërtetimit i bashkëlidhet situata e TVSH-së, si dhe dokumentacioni që provon ekzistencën e detyrimit nga skema e shtyrjes së TVSH-së.

12.2. Nga skema e kompensimit të TVSH-së, e cila rimbursohet nga drejtoritë rajonale tatimore për t'u paguar në doganë, përfiton vetëm personi i tatueshëm që plotëson njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) Nga përdorimi i shumës së TVSH-së kreditore në organet tatimore likuidohet vetëm shuma e TVSH–së së shtyrë në import me autorizim nga Ministri i Financave.

b) Burimi i TVSH-së, për të cilën personi i tatueshëm kërkon kompensim, të jetë nga i njëjti aktivitet që i shërben linja, për të cilën është aplikuar TVSH-ja e shtyrë;

c) Në rastet kur shuma e TVSH-së për t'u kompensuar është më e vogël se shuma e borxhit, të krijuar nga TVSH-ja e shtyrë në doganë, personi i tatueshëm duhet që më parë të paguajë diferencën.

12.3. Nëse plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, drejtoria rajonale tatimore, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e protokollimit të kërkesës së tatimpaguesit, kryen procedurat e mëtejshme për sistemimin dhe kontabilizimin e pozicioneve debitore dhe kreditore të TVSH-së, si dhe njofton degën doganore për miratimin e kërkesës së tatimpaguesit për kompensimin e TVSH-së. Në këtë njoftim, tatimpaguesi vihet në dijeni.

12.4. Me marrjen e këtij njoftimi, dega doganore mbyll situatën debitore të tatimpaguesit përmes ndryshimit të deklaratës doganore dhe, njëkohësisht, deklarata e ndryshuar dhe e miratuar nga organi doganor shërben për kontabilitetin e shoqërisë për tatimpaguesin. Dega doganore njofton drejtorinë rajonale tatimore për mbylljen e procedurës së kompensimit. Për debitorët, dega doganore i bën njoftim drejtorisë rajonale tatimore dhe, për vjeljen e detyrimit, organet tatimore marrin të gjitha masat sikur të ishte detyrim tatimor.

12.5. Pas miratimit nga dega doganore, drejtoria rajonale tatimore vlerëson situatën debitore të tatimpaguesit, automatikisht e çliruar, si dhe njofton me shkrim tatimpaguesin për situatën e tij debitore apo kreditore pas sistemimit, në të dyja administratat tatimore dhe doganore.

12.6. Shuma e TVSH-së kreditore në organet tatimore, e përdorur për të likuiduar shumën e TVSH-së të shtyrë në import, do të njihet si e ardhur në zyrën doganore, në të cilën zbatohet procedura.

12.7. Në përfundim të procedurës së kompensimit për çdo tatimpagues, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njoftojnë Ministrinë e Financave.".

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE_____

FORMULARI nr.1:

_____

Adresa:

_____

_____

Nr._____/ Prot. Tiranë, më_____/_____/_____

Referojuni në rast përgjigje

Drejtuar: _____(të dhënat e subjektit)

Referuar kërkesë suaj nr. _____, datë _____, protokolluar në drejtorinë rajonale tatimore _____, me nr._____prot., datë _____, dhe në mbështetje të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, u verifikua si më poshtë vijon:

1. Bazuar në aktkonstatimin nr._____, datë _____, pas verifikimit në terren, rezulton se makineri/pajisjet janë _____ (specifikohet ku ndodhen fizikisht, të magazinuara apo të vendosura në objekt, etj., si dhe në çfarë gjendjeje janë). Nga kjo konkludohet se makineri/pajisjet janë në proces montimi/instalimi dhe subjekti nuk i ka ende pajisjet në kushte pune, cikli i investimit nuk ka përfunduar.

2. Nga dokumentacioni (kontrolli i librave të shitjes, të blerjes, FDP, etj.) rezulton se tatimpaguesi nuk ka kryer shitje produktesh të prodhuara nga këto makineri/pajisje.

Si konkluzion, vërtetojmë se tatimpaguesi _____, mbajtës i NUS _____, nuk ka kryer:

1. Asnjë furnizim për të tretë;

2. Asnjë vetëfurnizim;

3. Asnjë përdorim për vete të produktit për të cilin kryhet investimi.

Nga verifikimi i situatës tatimore, rezulton se tatimpaguesi ka:

_____lekë kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. (vendoset shuma e detyrimeve të papaguara, ose "0" kur nuk ka detyrime).

Pas këtij verifikimi, subjekti është regjistruar në regjistrin e veçantë për t'u mbikëqyrur nga kjo drejtori, deri në furnizimin e parë, të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar prej tij.

Shënime._____

DREJTORI I DREJTORISË TATIMORE RAJONALE

_____(emër/mbiemër)

_____(firma, vula)

UDHËZIM
Nr. 7/1, datë 29.2.2012

PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR

Në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, neni 24 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Hyrje

Ky udhëzim përmban:

- tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015;
- transfertën e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore;
- procedurat dhe afatet për përgatitjen e buxhetit afatmesëm 2013-2015;
- mënyrën e llogaritjes së transfertave të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore.

2. Tavanet përgatitore të PBA-së

- Tavanet përgatitore të PBA-së për çdo program miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore brenda muajit mars 2012.
- Kuadri ekonomik 2013-2015 përcakton kontekstin ekonomik për programin buxhetor afatmesëm 2013-2015. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tri vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e qeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të PBA-së.

3. Transferta e pakushtëzuar e njësive të qeverisjes vendore

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitet 2013-2015 (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2012. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen, niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

- Transferta e pakushtëzuar për vitin 2013 do të jetë afërsisht 3% më e madhe se transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit e vitit 2012, ajo e vitit 2014, 4% më e lartë se ajo e vitit 2013, dhe transferta e vitit 2015 do të jetë 4% më e lartë se ajo e vitit 2014.

- Transferta e pakushtëzuar për periudhën 2013-2015.

Në mijë lekë

Bashki/komunë/qark	2013	2014	2015
Bashki/komunë	11.084	12.130	12.234
Qark	1.096	1.200	1.210
Totali	**12.180**	**13.330**	**13.444**

4. Procedurat dhe afatet për përgatitjen e PBA-së

- Kalendari i përgatitjes së PBA-së miratohet nga kryetari i grupit për menaxhim strategjik (GMS) së njësisë së qeverisjes vendore.

- DEMP-të, paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat shtesë sipas programit te nëpunësi autorizues i NjQV-së brenda datës 15 maj 2012.

- Kërkesat buxhetore të dorëzuara te nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore vlerësohen dhe miratohen nga GMS-ja e NjQV-së.

- Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore paraqet pranë këshillit të njësisë së qeverisjes vendore dokumentin e PBA-së 2013-2015, të miratuar nga GMS-ja, brenda datës 15 qershor 2012.

- Afati i dorëzimit të kërkesave buxhetore, bashkë me kërkesat shtesë nga drejtuesi i ekipit të menaxhimit të çdo programi te nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes vendore është 15 maj 2012.

- Kurset e këmbimit për vitet 2008-2011 dhe parashikimi për vitet 2013-2015, jepen si më poshtë:

Nr.	Monedhat	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
1	Kurs i këmbimit mesatar lekë/USD	83.9	95	103.9	100.9	102	102.5	104	104
2	Kurs i këmbimit mesatar lekë/euro	122.8	131.6	137.7	140.5	139.7	140	140	140.5

- Dokumenti i programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dërgohet në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore në muajin qershor.

- Brenda datës 1 qershor çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave, me shkrim dhe në rrugë elektronike, formularin nr. 1 “Parashikimi i të ardhurave për periudhën 2013-2015” dhe formularin nr. 2 “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2013-2015”, të shoqëruar me një relacion për mënyrën e llogaritjes së PBA-së (bashkëlidhur gjeni këta formularë).

5. Mënyrat e llogaritjes së transfertave, të pakushtëzuar dhe të kushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore

5.1 Transferta e pakushtëzuar

- Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2013-2015 do të jenë po ata të vitit 2012.

-Në bazë të shifrave të mësipërme të këtij udhëzimi, çdo njësi e qeverisjes vendore mund të bëjë në mënyrë individuale llogaritjen e nivelit të transfertës së pakushtëzuar.

Shembuj mbi llogaritjen e transfertës së pakushtëzuar

Koeficientët dhe metodika e përdorur më poshtë janë ato të vitit 20XX, të cilat do të jenë të vlefshme edhe për llogaritjen e periudhës 20XX-20XX
Grandi i përgjithshëm
Kriteri i popullsisë 70% = 8.855 milionë lekë
Kriteri i sipërfaqes së komunës 15% = 1,897 milionë lekë
Kriteri i shërbimeve urbane të bashkisë 15% = 1,898 milionë lekë
Llogaritja e transfertës së pakushtëzuar për bashkinë X
Informacion i përgjithshëm:
- Popullsia 56 297 banorë
- Të ardhura nga taksat e veta (taksa e biznesit të vogël+taksa e mjeteve të përdorura) në bashkinë X janë 1,200 lekë/frymë
- Të ardhura nga taksat e veta (taksa e biznesit të vogël+taksa e mjeteve të përdorura) në shkallë kombëtare janë 701 lekë/frymë
- Popullsia në shkallë kombëtare 4,268,984 banorë
- Popullsia urbane gjithsej 2,350,090 banorë
Llogaritja e grandit të përgjithshëm
1. Popullsia (56,297 banorë/4,268,984 banorë në shkallë kombëtare) = 0,0131 koeficienti i popullsisë. Nga kriteri i popullsisë bashkia X përfiton ((0.0131x8,855 milionë lekë)=116,774 mijë lekë.
2. Pjesa që i takon nga koeficienti i shërbimit urban (56,297 banorë/(2,350,984 popullsi që jeton në zonat urbane në shkallë kombëtare))=0.0239 koeficienti i shërbimeve urbane. Nga kriteri i shërbimeve urbane kjo bashki përfiton (0.0239 x 1,898 milionë lekë)=45,449 mijë lekë. Bashkia X, nga aplikimi i kritereve të mësipërme përfiton grand të përgjithshëm (116,774 + 45,449)=162,223 mijë lekë.
Ekuilizimi fiskal
3. Kapaciteti fiskal nga taksa e biznesit të vogël dhe taksa e automjeteve është 1,200 lekë/frymë. Mesatarja në shkallë kombëtare është 701 lekë/frymë. Diferenca në krahasim me atë në shkallë kombëtare (1,200-701)=+499 lekë/frymë. Çdo bashki dhe komunë me një të ardhur për frymë më të madhe se mesatarja nacionale, do të kontribuojë 25% të diferencës për ekualizim fiskal, në raport me popullsinë e saj; kjo shumë zbritet nga llogaritja fillestare e grandit. Çdo bashki dhe komunë që është më poshtë se sa mesatarja nacionale, do të kompensohet për 25% të kësaj diference në raport me popullsinë e saj; kjo shumë i shtohet llogaritjes fillestare të grandit. Në rastin e konkret, bashkia X do të kontribuojë për arsye të kapacitetit fiskal më të lartë se ajo në shkallë kombëtare me (((499x56297 banorë)/1000)x(25/100)))=28,092 mijë lekë, që do të thotë se grandi bëhet (162,223-28,092)=134,131 mijë lekë.
Rregullimet tranzitore
4. Grandi i përgjithshëm pas kapacitetit fiskal duke i shtuar taksën e biznesit të vogël dhe taksën e automjeteve është 67,556 mijë lekë.
5. Grandi për vitin 20XX, pas kryerjes së kompensimeve dhe shtesave gjatë vitit është 130,250 mijë lekë.
6. Diferenca nga krahasimi me vitin 20XX, është (134,131-130,250)=+3,881 mijë lekë.
7. Kufiri i sipërm i rritjes është +7%, në rastin konkret bashkia ka +3% dhe për rrjedhojë nuk i bën zbritje, sepse është brenda mesatares në shkallë kombëtare.
8. Grandi i përgjithshëm i bashkisë X është 134,131 mijë lekë.
Transferta e pakushtëzuar për këshillat e qarqeve
Transferta e pakushtëzuar për qarqet është ndarë në dy pjesë:
- Grandi i përgjithshëm (1,175x99) 99%=1,163 milionë lekë
- Fondi i kompensimit për qarqet (1,175x1) 1%=12 milionë lekë
Grandi i përgjithshëm
Shuma fikse 10%= 11,630 mijë lekë (për çdo qark)
Popullsia 28%= 32,563 mijë lekë
Treguesi gjeografik 30%= 34,890 mijë lekë
Koeficienti i rrugës 32%= 34,890 mijë lekë
- Llogaritja e transfertës së pakushtëzuar për qarkun X
Informacion i përgjithshëm:
- Popullsia 112,050 banorë
- Popullsia në shkallë kombëtare 4,268,984 banorë
- Treguesi gjeografik “M” (malore)
- Pesha gjeografike “5”
- Pesha gjeografike gjithsej në shkallë kombëtare “32”
- Gjatësia e rrugëve rurale rajonale që menaxhohen nga 12 qarqet 4289 km.
- Gjatësia e rrugëve rurale rajonale që menaxhohen nga qarku X 346 km
Llogaritja e grandit të përgjithshëm
1. Shuma fikse që i takon këtij qarku (11,630 mijë lekë/12 qarqe)=1,358 mijë lekë
2. Pjesa që i takon nga popullsia (112050 banorë/4,268,984 banorë në shkallë kombëtare)=0,02624 koeficienti i popullsisë. Nga kriteri i popullsisë, qarku X përfiton (0,02624x32,563 mijë)=8,546 mijë lekë
3. Pjesa që i takon nga treguesi gjeografik (5/32)=0,1563 koeficienti gjeografik. Nga kriteri i treguesit gjeografik, qarku X përfiton (0,1563x34,890 mijë lekë)=1,964 mijë lekë
4. Pjesa që i takon nga koeficienti i rrugës (346/4289)=0,0807 koeficienti i rrugës. Nga kriteri i koeficientit të rrugës, qarku X përfiton (0,0807x34,890 mijë lekë)=2,815 mijë lekë
Qarku x përfiton grand (1,358+8,546+1,964+2,815)=14,683 mijë lekë

5.2 Transferta e kushtëzuar

- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2013-2015, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë shërbimi i gjendjes civile, mbrojtja dhe administrimi i tokës, qendra e regjistrimit të bizneseve.

- Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

6. Ndjekja e procesit dhe mbështetja këshillimore

- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA-së 2013-2015, vë në dispozicion për çdo njësi të qeverisjes vendore, adresat e e-mailit:

fibrahimi@minfin.gov.al dhe jmemaj@minfin.gov.al

7. Të tjera

- Për sqarime të mëtejshme përveç këtij udhëzimi, mund të përdorni për analogji edhe udhëzimin nr. 7, datë 29.2.2012 "Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm 2013-2015".

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari 1

Parashikimi i të Ardhurave për periudhën 2013-2015

Ne mije leke

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2011	I pritshmi 2012	2013	2014	2015
I.	**Të ardhura nga taksa**					
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël					
2	Taksa mbi Ndertesat					
3	Taksa mbi token bujqesore					
4	Taksa e fjetjes në hotel					
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja					
6	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme					
7	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve					
8	Taksa për zënien e hapësirave publike					
9	Taksa e tabelës					
10	Taksa të përkohshme					
II.	**Të ardhura nga tarifat**					
1	Tarifa per pastrim					
2	Tarifa per hapesira publike					
3	Tarifa ujit te pijshem					
4	Tarife ndriçimi rrugor					
5	Tarife tabele					
6	Tarife gjelberimi					
7	Tarifa per Reklame					
8	Tarifa parkimi					
9	Tarifa per therjen e bagetive					
10	Tarife per sherbime te tjera administrative					
11	Tarife per sherbime sociale (arsim parashkollor konvikte)					
12	Sporte dhe kultura					
13	Tarifa te tjera					
III.	**Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera**					
1	Shitje Ndërtese					
2	Shitje Troje					
3	Shitje te pronave te ndryshem					
4	Qera Troje					
5	Qera nga Ndërtesat					
IV.	**Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme**					
V.	**Të ardhura të tjera**					
1	Transferta e Pakushtezuar					
2	Kredi dhe Hua					
3	Dhurata dhe sponsorizime te ndryshme					
	Total					

Nepunesi Autorizues
(_____)

Formulari 2

Parashikimi i Shpërndarjes së Burimeve Financiare për periudhën 2013-2015

Ne mije leke

Nr	Funksionet	Fakt 2011			I pritshmi 2012			2013			2014			2015		
		Paga Sigurime dhe operative	Invest	Totali	Paga Sigurime dhe operative	Invest	Totali	Paga Sigurime dhe operative	Invest	Totali	Paga Sigurime dhe operative	Invest	Totali	Paga Sigurime dhe operative	Invest	Totali
1	Administrata															
2	Pastrim Gjelberim															
3	Ujesjelles Kanalizime															
4	Menaxhimi Rrugor															
5	Transporti Publik															
6	Zhvillimi i Turizmit															
7	Strehimi dhe Urbanistika															
8	Ndriçimi Publik															
9	Zhvillimi ekonomik															
10	Mbrotja dhe Zhvillimi i Pyjeve lokale															
11	Mbrojtja e mjedisit															
12	Zhvillimi i Sportit															
13	Programe Kulturale															
14	Kujdesi Social															
15	Arsimi															
16	Shendetesia															
17	Emergjencat Civile															
18	Sherbimi borxhit afat-shkurter															
19	Sherbimi i borxhit afat-gjate															
20	Sherbime te tjera publike															
	Totali															

Nepunesi Autorizues
(_____)

UDHËZIM
Nr. 5, datë 16.2.2012

PËR SASITË E TREGTUESHME TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, VARIETETI I TË CILIT ËSHTË NË PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR, SI DHE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KËRKESËS PËR AUTORIZIMIN E IMPORTIT TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË CERTIFIKUAR JO PËRFUNDIMISHT OSE NË PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 6, pikës 4 të nenit 10 dhe pikës 4 të nenit 26 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Bujqësore dhe Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve,

UDHËZOJ:

I. Rregullat që përcaktohen

1. Në këtë udhëzim përcaktohen:

1.1 Sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar (KK), si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në KK.

1.2 Sasitë maksimale të mostrave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për speciet e bimëve, të destinuara për:

- testim varietor dhe për kontrolle zyrtare mbikëqyrëse;
- qëllime shkencore për punë seleksionuese varietore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik.

II. Rregullat për lejimin e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti që është në proces pranimi për regjistrim në KK

1. Për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti, i cili është në proces pranimi për regjistrim në KK, subjekti duhet të paraqesë kërkesë pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF) sipas modelit të pasqyruar në aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Lejimi i tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në KK, bëhet vetëm për ato specie të cilat ndodhen në tabelën e aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Subjekti i interesuar duhet të shoqërojë kërkesën e tij me dokumentacionin i cili provon vlerën për kultivimin dhe përdorimin e varieteteve në momentin e dorëzimit të mostrave për ekzaminim të varietetit, si dhe me dokumentacionin i cili duhet të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- specien;
- varietetin;
- përshkrimin agrobiologjik të varietetit;
- kërkesat e varietetit për kushtet klimatike dhe tokësore.

4. Subjekti i cili paraqet kërkesën, si dhe materiali mbjellës dhe shumëzues bimor mbi të cilin paraqitet kërkesa, duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera për tregtim të përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

5. Afati maksimal i lejimit të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të një varieteti që është në proces pranimi për regjistrim në KK është 3 (tre) vjet.

6. Subjekti të cilit i lejohet të tregtojë materialin në proces regjistrimi në KK, duhet ta identifikojë në mënyrë të dukshme dhe të qartë këtë material, pranë çdo vendi të tregtimit të tij, me shënimin “varietet në proces regjistrimi në KK”.

III. Rregullat për autorizimin e veçantë për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose të një varieteti që është në proces pranimi për regjistrim në KK

1. Për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht dhe/ose të një varieteti i cili është në proces pranimi për regjistrim në KK, subjekti duhet të paraqesë një kërkesë për autorizim të veçantë pranë ESHFF-së, sipas modelit të pasqyruar në aneksin nr.3, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

IV. Sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që nuk konsiderohen produkt për tregtim

1. Sasia maksimale e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të varieteteve të bimëve bujqësore që konsiderohet mostër për kontrolle zyrtare mbikëqyrëse, për qëllime shkencore, për punë seleksionuese varietore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik është dhënë në tabelën e aneksit 1 të këtij udhëzimi.

2. Mostra të këtij materiali (farë) duhet të shënohen në mënyrë të qartë që është një material i një varieteti të destinuar për qëllim kontrolli zyrtar mbikëqyrës, për qëllime shkencore, për punë seleksionuese varietore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik.

3. Dokumentacioni që shoqëron mostrat e materialit mbjellës bimor, krahas destinacionit për qëllimin e përdorimit, të përmbajë dhe të dhënat e mëposhtme:

- specien;
- varietetin;
- sasinë e materialit mbjellës;

- kategorinë (sipas rastit të destinacionit).

V. Dispozita të fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

ANEKSI 1
SASITË E MATERIALIT MBJELLËS SIPAS SPECIEVE

Nr.	**Emri latinisht**	**Emri shqip**	**Tregtimi i materialit mbjellës, varieteti i të cilit është në proces për regjistrim në katalog kg**		**Mostrat e destinuara për testim varietor kg**	**Mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik fara**
			njësia	sasia		
	1	2	3	4	5	6
I.	**Cerealet**					
1	*A vena sativa* L.	Tërshëra	ton	10	20	40000
2	*Hordeum vulgare* L.	Elbi	ton	10	20	40000
3	*Panicum miliaceum* L.	Meli	ton	5	20	40000
4	*Secale cereale* L.	Thekra	ton	10	20	40000
5	*Sorghum bicolor* (L.) Moench	Melakuqja	ton	5	20	40000
6	*Sorghum bicolor* (L.) Moench. X *Sorghum sudanense* Stapf.	Sorgumi sudanez	ton	5	20	40000
7	X Tritico secale Wittm.	Tritikale	ton	10	20	40000
8	*Triticum aestivum* L. Emend. Fiori et Paol.	Gruri i butë	ton	20	20	40000
9	*Triticum durum* Desf.	Gruri i fortë	ton	20	20	40000
10	*Triticum spelt a* L.	Tepa	ton	10	20	40000
11	*Zea mays* L. (partim)	Misri	ton	5	5	40000
12	*Oryza sativa L.*	Orizi	ton	10	10	40000
II.	**Bimët foragjere**					
II.A	**Barërat**					
1	*Agrostis sp.* L.	Barimëza	ton	1	0.1	40000
2	*Alopecurus pratensis* L.	Bishtdhelpra livadhore	ton	1	0.1	40000
3	*Bromus catharticus* Vahl	Bromusi	ton	1	0.1	40000
4	*Bromus sitchensis* Trin.	Bromusi i Alaskës	ton	1	0.1	40000
5	*Cynodon dactylon* (L.) Pers.	Grami	ton	1	0.1	40000
6	*Dactylis glomerata* L.	Telishi	ton	1	0.1	40000
7	*Festuca arundinacea* Schreber	Festuka si kallam	ton	1	0.1	40000
8	*Festuca ovina* L.	Festuka e deleve	ton	1	0.1	40000
9	*Festuca pratensis* Hudson	Festuka livadhore	ton	1	0.1	40000
10	*Festuca rubra* L.	Festuka e kuqe	ton	1	0.1	40000
11	*Lolium multijlorum* Lam.	Lolium shumëlulesh	ton	1	0.1	40000
12	*Lolium perenne* L.	Lolium shumëvjeçar	ton	1	0.1	40000
13	*Phleum pratense* L.	Fleumi livadhor	ton	1	0.1	40000
14	*Poa annua* L.	Flokësi njëvjeçar	ton	1	0.1	40000
15	*Poa nemoralis* L.	Flokësi i pyjeve	ton	1	0.1	40000
16	*Poa palustris* L.	Flokësi i ligatinave	ton	1	0.1	40000
17	*Poa pratensis* L.	Flokësi livadhor	ton	1	0.1	40000

18	*Poa trivialis* L.	Flokësi i zakonshëm	ton	1	0.1	40000
19	*Trisetum flavescens* (L.) P. Beauv.	Triseta e zbehtë	ton	1	0.1	40000
II.B	**Legominozet**					
1	*Lotus corniculatus* L.	Tërfili me brirë	ton	1	0.1	40000
2	*Lupinus albus* L.	Lupini i bardhë	ton	10	1	40000
3	*Lupinus angustifolius* L.	Lupini gjethengushtë	ton	10	1	40000
4	*Lupinus luteus* L.	Lupini i verdhë	ton	10	1	40000
5	*Medicago lupulina* L.	Jonxha lupulinë	ton	5	0.3	40000
6	*Medicago sativa* L.	Jonxha	ton	5	0.3	40000
7	*Medicago x varia* T. Martyn	Jonxha e ranishteve	ton	5	0.3	40000
8	*Pisum sativum* L. (partim)	Bizelja	ton	10	2	40000
9	*Trifolium alexandrinum* L.	Tërfili aleksandrin	ton	5	0.2	40000
10	*Trifolium hybridum* L.	Tërfili hibrid	ton	5	0.2	40000
11	*Trifolium incarnatum* L.	Tërfili i kuqërremtë	ton	5	0.2	40000
12	*Trifolium pratense* L.	Tërfili livadhor	ton	5	0.2	40000
13	*Trifolium repens* L.	Tërfili zvarritës	ton	5	0.2	40000
14	*Trifolium resupinatum* L.	Tërfili persian	ton	5	0.2	40000
15	*Vicia faba* L. (partim)	Batha	ton	10	2	40000
16	*Vicia pannonica* Crantz	Grashina panoneze	ton	10	2	40000
17	*Vicia sativa* L.	Koçkulla	ton	10	2	40000
18	*Vicia villosa* Roth.	Grashina	ton	10	2	40000
II.C	**Bimë të tjera foragjere**					
1	*Brassica napus* L var. *Napobrassica* (L) Rchb.	Sinapi	ton	5	0.2	40000
2	*Brassica oleracea* L. convar. *Acephala* (DC.)	Lakra	ton	5	0.2	40000
3	*Phacelia tanacetifolia* Benth.	Këmbanorja blu	ton	5	0.2	40000
4	*Raphanus sativus* L. var. *Oleiformis* Pers.	Rrepa foragjere	ton	5	0.2	40000
III	**Panxhari**		ton			
1	*Beta vulgaris* L. ssp. *vulgaris* var. *alba*, DC.	Panxhari	ton	10	0.5	40000
IV	**Duhani**					
1	*Nicotiana tabacum* L.	Duhani	kg	20	0.02	40000
V	**Pambuku**					
1	*Gossypium Hirsitum* L.	Pambuku	kg	200	0.2	40000
VI	**Bimët vajore dhe fibroze**					
1	*Brassica napus* L. (par*tim)*	Sinapi	kg	200	0.2	40000
2	*Brassica nigra* (L.) Koch	Lakra e zezë	kg	200	0.2	40000
3	*Brassica rapa* L. var. (Lam.) Briggs	Kolza	kg	200	0.1	40000
4	*Cannabis sativa* L.	Kërpi	kg	50	0.2	40000
5	Glycine max (L.) Merill	Soja	ton	10	1	40000
6	*Helianthus annuus* L.	Luledielli	ton	5	1	40000
7	*Linum usitatissimim* L.	Lini	kg	50	0.2	40000
8	*Arachis hypogea*	Kikiriku	kg	500	1	40000
VII	**Patatja**					
1	*Solarium tuberosum* L.	Patatja	ton	25	150	
VIII	**Perimet**					
1	*Allium cepa* L.	Qepa	kg	10	0.3	40000
2	*Allium porrum* L.	Preshi	kg	10	0.3	40000
3	*Allium sativum* L.	Hudhra	kg	10	0.3	40000
4	*Anthriscus cerefolium L. Hoffm.*	Fier moskat	kg	10	0.05	40000
5	*Apium graveolens* L.	Selino	kg	10	0.02	40000
6	*Asparagus officinalis* I.	Asparagusi	kg	10	0.1	40000
7	*Beta vulgaris* L. var. *vulgaris*	Panxhar zakonshëm	kg	200	0.1	40000
8	*Beta vulgaris* L. var *conditiva* Alef.	Panxhar i kuq	kg	200	0.1	40000
9	Brassica oleracea L. convar. *acephala* (DC) Alef. var *sabellica*	Lakra kokë	kg	200	0.3	40000

	L.					
10	*Brassica oleracea* L. convar. *botrytis* (L) Alef. var. *botrytis* L.	Lulelakra	kg	200	0.3	40000
11	*Brassica oleracea* L. convar. *botrytis* (L.) Alef. var. *cymosa*	Brokoli i hollë	kg	200	0.3	40000
12	*Brassica oleracea* L. convar. *botrytis* (L.) Alef. var. *italica Plenck.*	Brokoli kokë	kg	200	0.3	40000
13	*Brassica oleracea* L. convar. *oleracea* var. *gemmifera* DC	Lakra e Brukselit	kg	200	0.3	40000
14	*Brassica oleracea* L. convar *capitata* (L) Alef. var. *subauda* L.	Lakra e Savojës	kg	200	0.3	40000
15	*Brassica oleracea* L. convar. *capitata* (L.) Alef. var *alba* DC	Lakra kokë bardhë	kg	200	0.3	40000
16	*Brassica oleracea* L. convar. *capitata* (L.) Alef. var *rubra* DC	Lakra kokë kuqe	kg	200	0.3	40000
17	*Brassica oleracea* L. convar. *acephala* (DC) Alef. var. *gongylodes*	Kolrabi	kg	200	0.3	40000
18	*Brassica pekinensis* (Lour.) Rupr.	Lakra kineze	kg	200	0.3	40000
19	*Brassica rapa* L. var. *rapa*	Rilka	kg	200	0.3	40000
20	*Capsicum annuum* L.	Speci	kg	10	0.04	40000
21	*Cichorium endivia* L.	Endivia	kg	5	0.02	40000
22	*Cichorium intybus* L. (partim)	Çikorja	kg	5	0.02	40000
23	*Citrullus lanatus* (Thunb.) Matsum. et Nakai	Shalqiri	kg	20	0.3	40000
24	*Cucumis melo* L.	Pjepri	kg	20	0.2	40000
25	*Cucumis sativus* L.	Trangulli	kg	20	0.03	40000
26	*Cucurbita maxima* L.	Kungulli i ëmbël	kg	20	0.3	40000
27	*Cucurbit a pepo* L.	Kungulli zakonshëm	kg	20	0.3	40000
28	*Cucurbita pepo* L. *var. Styriaca Greb*	Kungulli i verdhë	kg	20	0.3	40000
29	*Daucus carota* L.	Karota	kg	5	0.1	40000
30	*Foeniculum vulgare* Miller.	Finoku	kg	5	0.02	40000
31	*Hybiscus esculentum*	Bamja	kg	500	0.5	40000
32	*Lactuca sativa* L.	Sallata	kg	5	0.01	40000
33	*Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farë.	Domatja	kg	1	0.01	40000
34	*Petroselinum crispum* (Miller) Nyman ex A.w.Hill	Majdanozi	kg	5	0.01	40000
35	*Phaseolus coccineus* L.	Barbunja	ton	10	3	40000
36	*Phaseolus vulgaris* L.	Fasulja	ton	10	3	40000
37	*Pisum sativum* L. (fnartim)	Bizelja	ton	5	2	40000
38	*Raphanus sativus* L.	Rrepa	kg	5	0.2	40000
39	*Solarium melongena* L.	Patëllxhani	kg	10	0.05	40000
40	*Spinacia oleracea* L.	Spinaqi	kg	500	0.1	40000
41	*Valerianella locusta* (L) Laterr.	Valeriana	kg	50	0.02	40000
42	*Vicia faba* L. (partim)	Batha	kg	500	4	40000
43	*Zea mays* L. (partim)	Misri i ëmbël	ton	5	5	40000
IX	**Hardhia**				fidanë	fidanë
1	*Vitis* spp.	Hardhia	fidanë	10000	20	100*
X	**Sumullbari (Humulusi)**					
1	*Humulus lupulus* L.	Sumullbari (Humulusi)	fidanë	5000	20	50*
XI	**Bimët drufrutore**				fidanë	fidanë

* Sasitë e fidanëve që nevojiten për punë shkencore

1	*Castanea sativa* Mill.	Gështenja	fidanë	20000	20	10*
2	*Citrus limon* (L.) Burm. f. *lemon*	Limoni	fidanë	5000	20	10*
3	*Citrus reticulata* Blanco	Mandarina	fidanë	5000	20	10*
4	*Citrus sinensis* (L.) Pers.	Portokalli	fidanë	5000	20	10*
5	*Citrus x paradisi* Macfad.	Grapefruiti	fidanë	5000	20	10*
6	*Citrus medica*	Qitro	fidanë	5000	20	10*
7	*Citrus auranifolia* (Christm.) Swing	Nerënxa	fidanë	5000	20	10*
8	*Cydonia* spp.	Ftoi	fidanë	10000	20	10*
9	Cornus mas L.	Thana	fidanë	5000	20	10*
10	*Corylus avellana* L.	Lajthia	fidanë	30000	20	10*
11	*Diospyros kaki* L.	Hurma (Kakia)	fidanë	10000	20	10*
12	*Fragaria x ananassa* Duch.	Luleshtrydhja	fidanë	100000	20	10*
13	*Ficus carica*	Fiku	fidanë	5000	20	10*
14	*Zizyphus Zizyphus*	Hidja (xinxifja)	fidanë	10000	20	10*
15	*Juglans regia* L.	Arra	fidanë	100000	20	10*
16	*Actinidia* sp.	Kivi (Aktinidia)	fidanë	20000	20	10*
17	*Malus* Mill.	Molla	fidanë	20000	20	10*
18	*Morus* sp.	Mani	fidanë	5000	20	10*
19	*Mespilus germanica*	Mushmolla dimërore	fidanë	5000	20	10*
20	*Eriobotrya japonica*	Nespola	fidanë	5000	20	10*
21	*Olea europaea* L.	Ulliri	fidanë	50000	20	10*
22	*Poncirus trifogliata*	Trifoljata	fidanë	5000	20	10*
23	*Pistacia verra L.*	Pistaku	fidanë	5000	20	10*
24	*Prunus amygdalus* Batsch	Bajamja	fidanë	10000	20	10*
25	*Prunus armeniaca* L.	Kajsia	fidanë	5000	20	10*
26	*Prunus avium* L.	Qershia	fidanë	5000	20	10*
27	*Prunus cerasus* L.	Vishnja	fidanë	5000	20	10*
28	Prunus domestica L.	Kumbulla gjatore	fidanë	5000	20	10*
29	*Prunus persica* (L.) Batsch	Pjeshka	fidanë	5000	20	10*
30	*Prunus salicina* Lindl.	Kumbulla japoneze	fidanë	5000	20	10*
31	*Pyrus communis* L.	Dardha	fidanë	5000	20	10*
32	*Punica granatum*	Shega	fidanë	20000	20	10*
33	*Ribes* spp.	Ribes	fidanë	5000	20	10*
34	*Rubus* spp.	Mjedra	fidanë	5000	20	10*
35	Vaccinium L.	Boronica	fidanë	5000	20	10*
XII	**Bimët medicinale**					
1	*Salvia Officinalis*	Sherebela	x	x	x	x
2	*Thymus Vulgaris*	Timus	x	x	x	x
3	*Lavandula officinalis*	Lavanda	x	x	x	x
4	*Origanum Vulgaris*	Rigoni	x	x	x	x

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Tiranë, më ___ / ___ / _____

ANEKSI 2

KËRKESË PËR TREGTIM TË PËRKOHSHËM

Drejtuar: ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

Tiranë

Kërkesë për lejimin e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces pranimi për regjistrim në Katalogun Kombëtar.

a. Të dhëna për kërkuesin:

1. Emri e mbiemri i subjektit:
2. Adresa:
3. Nr. i licencës:
4. Numri i identifikimit të subjektit:

b. Të dhëna për personin e autorizuar:

5. Emri e mbiemri:
6. Adresa:
7. Numri i dokumentit të identifikimit:

c. Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për të cilin kërkohet leja e tregëtimit:

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	Vendi nga importohet *
1						
2						
3						
4						
5						

d. Afati kohor për të cilën kërkohet leja për tregtim: …… (max. 3 vjet)

Për subjektin:

……

Emër/mbiemër dhe firma e përfaqësuesit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Tiranë, më ___ / ___ / _____

ANEKSI 3

KËRKESË PËR AUTORIZIM TË VEÇANTË TË IMPORTIT

Drejtuar: ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

Tiranë

1. Për pajisjen me autorizim të veçantë të importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht dhe/ose, të varietetit i cili është në proces pranimi për regjistrim në Katalogun Kombëtar.

2. Kërkoj lëshimin e autorizimit të importimit të veçantë të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor nga shteti (*vendos shtetin nga importohet*) _____ për arsye (*vendos rastet e parashikuara në nenin 26, ligji nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor*"): _____

a. Të dhëna për kerkuesin:

1. Emri e mbiemri i subjektit:
2. Adresa:
3. Nr. i licencës:
4. Numri i identifikimit të subjektit:

b. Të dhëna për personin e autorizuar:

5. Emri e mbiemri:
6. Adresa:
7. Numri i dokumentit të identifikimit:

c. Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për të cilin kërkohet autorizim importi:

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	Vendi nga importohet *
1						
2						
3						
4						
5						

d. Afati kohor për të cilën kërkohet leja për tregtim: …… (max. 3 vjet)

Për subjektin:

……

Emër/mbiemër dhe firma e përfaqësuesit

URDHËR
Nr. 42, datë 16.2.2012

PËR SPECIET E BIMËVE, VARIETETI I TË CILAVE DUHET TË REGJISTROHET NË KATALOGUN KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Bujqësore dhe Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve,

URDHËROJ:

1. Lista e specieve, varieteti i të cilave duhet të regjistrohet në Katalogun Kombëtar, është sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore të përgatitë brenda 6 muajve nga miratimi i këtij urdhri, listën e specieve të bimëve dekorative dhe të bimëve pyjore, varieteti i të cilave duhet të regjistrohet në Katalogun Kombëtar.
3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.
4. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

TABELA NR.1

Drithrat	
Avena saliva L.	Tërshëra e zakonshme
Hordeum vulgare L.	Elbi
Panicum miliaceum L.	Meli
Secale cereale L.	Thekra
Sorghum bicolor (L.) Moench	Melakuqja
Sorghum sudanense Stapf.X Tritico secale Wittm.	Sorgumi sudanez
xTrititicosecale Witim	Tritikalet
Triticum aestivum L. Emend. Fiori et Paol.	Grurë i butë
Triticum durum Desf.	Grurë i fortë
Triticum spelt a L.	Tepa
Zea mays L. (partim)	Misri
Oryza sativa L.	Orizi
Bimët foragjere, barërat	
Agrostis sp L.	Barimëza bisht qeni
Alopecurus pratensis L.	Bisht dhelpra e livadhit
Arrhenatlierum elatius (L.)	Arrenatera e lartë (tërshërë)
Bromus catharticus Vahl	Bromusi
Bromus sitchensis Trin.	Bromusi i Alaskës

Cynodon dactylon (L.) Pers.	Grami
Dactylis glomerata L.	Telishi
Festuca arundinacea Schreber	Festuka si kallam
Festuca ovina L.	Festuka e deleve
Festuca pratensis Hudson	Festuka e livadhit
Festuca rubra L.	Festuka e kuqe
Lolium multijlorum Lam.	Loliumi shumëlulësh
Lolium perenne L.	Loliumi shumëvjeçar
Phleum pratense L.	Fleumi livadhor
Poa annua L.	Flokësi njëvjeçar
Poa nemoralis L.	Flokësi e pyjeve
Poa palustris L.	Flokësi i ligatinave
Poa pratensis L.	Flokësi livadhor
Poa trivialis L.	Flokësi i zakonshëm
Trisetum flavescens (L.) P. Beauv	Triseta e zbehtë
Leguminozet	
Lotus corniculatus L.	Tërfili me brirë
Lupinus albus L.	Lupini i bardhë
Lupinus angustifolius L.	Lupini gjethengushtë
Lupinus luteus L.	Lupini i verdhë
Medicago lupulina L.	Jonxha lupin
Medicago sativa L.	Jonxha
Medicago x varia T. Martyn	Jonxha e ranishteve (hibride)
Pisum sativum L. (partim)	Bizelja
Trifolium alexandrinum L.	Tërfili aleksandrin
Trifolium hybridum L.	Tërfili hibrid
Trifolium incarnatum L.	Tërfili i kuqërremtë
Trifolium pratense L.	Tërfili livadhor
Trifolium repens L.	Tërfili zvarritës
Trifolium resupinatum L.	Tërfili persian
Vicia faba L. (partim)	Batha
Vicia pannonica Crantz	Grashina panoneze
Vicia sativa L.	Koçkulla
Vicia villosa Roth	Grashina
Bimë të tjera foragjere	
Brassica napus L var. napobrassica (L) Rchb.	Sinapi
Brassica oleracea L. convar. acephal(DC.) Alef. var. medullosa Thell.a	Lakra e zakonshme
Phacelia tanacetifolia Benth.	Këmbanorja blu
Raphanus sativus L. var. oleiformis Pers.	Rrepa foragjere
Bimë industriale:	
Beta vulgaris L. ssp. vulgaris var. alba DC.	Panxhari
Nicotiana tabacum L.	Duhani
Gossipium hirsitum L.	Pambuku

Bimët vajore dhe fibroze	
Brassica napus L. (partim)	Sinapi
Brassica nigra (L.) Koch	Lakra e zezë
Brassica rapa L. var. silvestris (Lam.) Briggs	Kolëza
Cannabis sativa L.	Kërpi
Glycine max (L.) Merill	Soja
Helianthus annuus L.	Luledielli
Linum usitatissimum L.	Liri
Arachis hypogea	Kikiriku
Patatja	
Solarium tuberosum L	Patatja
Perimet	
Allium cepa L.	Qepa
Allium porrum L.	Preshi
Allium sativum L.	Hudhra
Anthriscus cerefolium (L.) Hoffm.	Fier moskat
Apium graveolens L.	Selinon
Asparagus officinalis I.	Asparagusi
Beta vulgaris L. var. Vulgaris	Panxhari i zakonshëm
Beta vulgaris L. var conditiva Alef.	Panxhari i kuq
Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var sabellica L.	Lakra kokë (jeshile)
Brassica oleracea L. convar. botrytis (L) Alef. var. botrytis L.	Lulelakra
Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var. cymosa	Brokoli i hollë
Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var.italica Plenck	Brokoli kokë
Brassica oleracea L. convar. oleracea var. gemmifera DC	Lakra e Brukselit
Brassica oleracea L. convar capitata (L) Alef. var. subauda L.	Lakra e Savojës
Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var alba DC	Lakra kokëbardhë
Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var rubra DC	Lakra kokëkuqe
Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var. gongylodes	Kohlrabi
Brassica pekinensis (Lour.) Rupr.	Lakra kineze
Brassica rapa L. var. rapa	Rilka
Capsicum annuum L.	Speci
Cichorium endivia L.	Endivia
Cichorium intybus L. (partim)	Çikoria
Citrullus lanatus (Thunb.) Matsum. et Nakai	Shalqiri
Cucumis melo L.	Pjepri
Cucumis sativus L.	Trangulli
Cucurbita maxima L.	Kungulli i ëmbël
Cucurbita pepo L.	Kungulli i zakonshëm
Cucurbita pepo L. var. styriaca Greb	Kungulli i madh i verdhë
Cynara cardunculus L.	Angjinarja
Daucus carota L.	Karota
Foeniculum vulgare Miller.	Finoku
Hybiscus esculentus	Bamja

Lactuca sativa L.	Sallata
Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farë.	Domatja
Petroselinum crispum (Miller) Nyman ex A.ë.Hill	Majdanozi
Phaseolus coccineus L.	Barbunja
Phaseolus vulgaris L.	Fasulja
Pisum sativum L. fnartim) (partim)	Bizelja
Raphanus sativus L.	Rrepa
Solarium melongena L.	Patëllxhani
Spinacia oleracea L.	Spinaqi
Valerianella locusta (L) Laterr.	Valeriana
Vicia faba L. (partim)	Batha
Zea mays L. (partim)	Misri i ëmbël
Hardhia	
Vitis spp.	Hardhia
Humulusi (sumullbari)	
Humulus lupulus L.	Humulusi (sumullbari)
Bimët drufrutore	
Castanea sativa Mill.	Gështenja
Citrus sinensis (L.) Pers.	Portokalli
Citrus limon (L.) Burm. f.	Limoni
Citrus reticulata Blanco	Mandarina
Citrus paradisi Macf.	Greipfrut
Citrus aurantifolia (Christm.)Swing	Nerënxa
Citrus Medica	Qitro
Cydonia spp.	Ftoi
Cornus mas L.	Thana
Corylus avellana L.	Lajthia
Diospyros Kaki L.	Hurma (kakia)
Fragaria x ananassa Duch.	Luleshtrydhja
Ficus carica	Fiku
Zizyphus zizyphus	Hidja (xinxifja)
Juglans regia L.	Arra
Actinidia sp.	Kivi (Aktinidia)
Malus Mill.	Molla
Morus sp.	Mani
Mespilus germanica	Mushmolla dimërore
Eriobotrya japonica	Nespola
Olea europaea L.	Ulliri
Poncirus trifogliata	Trifoljata
Pistacia verra L.	Pistaku
Prunus amygdalus Batsch	Bajamja
Prunus armeniaca L.	Kajsia
Prunus avium L.	Qershia
Prunus cerasus	Vishnja
Prunus domestica L.	Kumbulla gjatore

Prunus persica (L.) Batsch	Pjeshka
Pyrus communis L.	Dardha
Prunus Salicina Japanese	Kumbulla japoneze
Punica granatum	Shega
Ribes spp.	Ribes
Rubus spp.	Mjedra
Vaccinium L.	Boronica
Bimët medicinale	
Salvia Officinalis	Sherebela
Thymus Vulgaris	Timus
Lavandula officinalis	Lavanda
Origanum Vulgaris	Rigoni

VENDIM
Nr. 18, datë 2.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	Anëtar i		“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i		“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i		“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“	
Sokol Berberi	Anëtar i		“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“	
Admir Thanza	Anëtar i		“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“	

me sekretare Edmira Babaj, në datën 19.1.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 56/31 akti, që i përket:

KËRKUES: Shkëlqim Qosja, përfaqësuar nga avokatët Ndue Pjetra dhe Ëngjëll Allajbej, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 67, datë 2.5.2001 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2011-437 (66), datë 28.4.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42/2 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Shkëlqim Qosja është gjykuar në mungesë për kryerjen e veprave penale të vrasjes me paramendim, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal (KP), dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së.

2. Me vendimin nr. 258, datë 18.7.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprave penale të mësipërme dhe, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar me 20 vjet burgim.

3. Me vendimin nr. 137, datë 6.10.2000, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4. Me vendimin nr. 90, datë 8.2.2001, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 137, datë 6.10.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Me vendimin nr. 67, datë 2.5.2001, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 258, datë 18.7.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim.

6. Me vendimin nr. 87, datë 3.6.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit Shkëlqim Qosja për rivendosje në afatin e ankimit, duke i njohur atij të drejtën për të ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 67, datë 2.5.2001 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

7. Me vendimin nr. 00-2011-437 (66), datë 28.4.2011 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 67, datë 2.5.2001 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

8. ***Kërkuesi*** pretendon para Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) se në proceset e zhvilluara në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Lartë janë cenuar këto elemente të procesit të rregullt:

8.1. Është cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës, pasi në përbërje të trupit gjykues që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Shkodër, në kundërshtim me nenin 15 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka marrë pjesë një gjyqtar i cili ka qenë më parë në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar, në po këtë gjykatë, ankimin kundër masës së sigurimit të dhënë për kërkuesin.

8.2. Është cenuar e drejta e mbrojtjes në Gjykatën e Lartë, pasi gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit dhe kjo gjykatë nuk ka bërë asnjë përpjekje për të siguruar praninë e tij në seancën gjyqësore. Kërkuesi, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, nuk është njoftuar në një kohë të arsyeshme për procesin, për të përgatitur mbrojtjen e tij.

8.3. Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë akuza ka pasur përfaqësuesin e saj, kurse kërkuesi nuk ka pasur mundësi të shprehë pretendimet e tij, nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij.

9. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet dërguar me shkrim Gjykatës, shprehet se:

9.1. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, në rastin në shqyrtim, pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar si në përbërje të kolegjit që ka shqyrtuar ankimin e prokurorit mbi masën e sigurimit, ashtu edhe në kolegjin që ka shqyrtuar themelin e çështjes, nuk përbën papajtueshmëri në kuptim të nenin 15/2 të KPP-së dhe as shkak për heqje dorë nga gjykimi në kuptim të nenit 17/1, shkronja "e", të KPP-së. Në vendimin për ndryshimin e masës së sigurimit Gjykata e Apelit Shkodër, pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të rrethanave të faktit dhe ligjit ka vendosur mospranimin e ankimit, për shkak të heqjes dorë të prokurorit nga ankimi.

9.2. I pabazuar është edhe pretendimi për mohimin e të drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë. Në këtë gjykatë rezulton se njoftimi për seancën gjyqësore është bërë në përputhje me afatet dhe dispozitat procedurale. Nga prokura e posaçme, e administruar në dosjen gjyqësore, rezulton se kërkuesi ka shprehur vullnetin për mospjesëmarrjen në gjykim dhe për përfaqësimin në mungesë të tij nga avokati i zgjedhur. Në këto kushte, këtij mbrojtësi i lindte detyrimi të interesohej pranë

Gjykatës së Lartë për datën dhe orën e gjykimit për të përfaqësuar kërkuesin. Për më tepër, duke qenë se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e ushtruar nga vetë kërkuesi, qëndrimi i tij dhe i mbrojtësit ishte shprehur në rekurs.

II

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë

10. Kërkuesi pretendon se në gjykimin e kësaj çështjeje është shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Konkretisht, sipas tij, në gjykimin në gjykatën e apelit ka marrë pjesë një gjyqtar që kishte marrë pjesë më parë në shqyrtimin e ankimit ndaj masës së sigurimit të dhënë ndaj tij.

11. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që, në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast palët në gjykim. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e tij *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme në formimin e trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv (*shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se i njëjti gjyqtar i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka qenë në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin për themelin e çështjes (vendimi nr. 67, datë 2.5.2001), ka qenë më parë në përbërje të trupit gjykues që ka marrë në shqyrtim ankimin e prokurorit ndaj masës së sigurimit për kërkuesin (vendimi nr. 23, datë 2.11.1999), vendim me të cilin është vendosur mospranimi i ankimit për shkak të heqjes dorë të prokurorit prej tij.

13. Me qëllim të respektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, neni 15/2 i KPP-së parashikon se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim. Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17/1, shkronja "e" i KPP-së, sipas të cilit gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga neni 15 i KPP-së. Ligji nuk përjashton që gjyqtari, i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj apo të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vleftësuar çdo kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e çështjes (*shih vendimin nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vëren se neni 15/2 i KPP-së shprehet se "nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar…", çka do të thotë se kjo dispozitë kërkon që gjyqtari të shprehet lidhur me themelin e masës së sigurimit. Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkodër në gjykimin e masës së sigurimit ka qenë formale dhe ai nuk ka dhënë asnjë mendim lidhur me thelbin e çështjes, duke qenë se prokurori i çështjes hoqi dorë nga ankimi i paraqitur në atë gjykatë. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky gjyqtar nuk gjendet në kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuar në nenin 15/2 të KPP-së, dhe nuk kishte arsye për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes konkrete në themel.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk gjendet para cenimit të parimit të paanshmërisë dhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve

15. Kërkuesi pretendon se në gjykimin në Gjykatën e Lartë është cenuar e drejta e mbrojtjes, pasi ai nuk është njoftuar në kohë të arsyeshme për procesin, për të përgatitur mbrojtjen e tij, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka cenuar edhe parimin e barazisë së armëve, pasi akuza ka pasur përfaqësuesin e saj në gjykim, kurse kërkuesi nuk ka pasur mundësinë të shprehë pretendimet e tij nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij.

16. Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*shih vendimet nr. 23, datë 13.10.2005; nr. 24, datë 26.10.2005; nr. 16, datë 8.6.2006; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 10, datë 2.4.2009; nr. 16, datë 15.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, është vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëllojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore, për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij, nuk është e domosdoshme, nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në këtë rast, nëse as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë në Gjykatën e Lartë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave, në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (*shih vendimet nr. 23, datë 13.10.2005; nr. 24, datë 26.10.2005; nr. 5, datë 4.2.2008; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 16, datë 15.6.2009; nr .28, datë 2.10.2009; nr. 30, datë 26.11.2009; nr. 37, datë 24.12.2010; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në qëndrimet e arsyetimet e veta Gjykata, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, ka pranuar gjithashtu se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe

elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, nga dosja gjyqësore rezulton se gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë të kërkuesit dhe mbrojtësit të tij. Në procesverbalin e seancës gjyqësore shënohet se mbrojtësi ka dijeni dhe se ka arsye objektive për mospjesëmarrjen në gjykim. Gjykata vlerëson se, edhe pse pranohet se përgjithësisht seancat nuk duhet të zhvillohen në mungesë të mbrojtësit të personit të akuzuar, në rastin në shqyrtim shkaku i vetëm i paraqitur në rekurs prej kërkuesit, është pavlefshmëria absolute e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, si pasojë e pjesëmarrjes në gjykim të të njëjtit gjyqtar që kishte marrë pjesë më parë në shqyrtimin e ankimit ndaj masës së sigurimit, pretendim të cilit Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të arsyetuar në vendimin e saj dhe, siç u arsyetua më sipër, është i pabazuar. Gjykata vëren, gjithashtu, se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi dhe, në këto kushte, duke qenë se të gjitha argumentet ligjore kanë qenë të depozituara me shkrim në rekurs, Gjykata e Lartë nuk kishte ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të mbrojtësit të kërkuesit. Në përfundim të gjykimit, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë dhënë një vendim që të ketë rënduar pozitën e kërkuesit, pra të ketë ndryshuar në disfavor të tij vendimet e gjykatave më të ulëta.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në tërësinë e tij, nuk ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit dhe as barazinë e armëve dhe, në këto kushte, edhe ky pretendim është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Fatmir Hoxha

VENDIM
Nr. 19, datë 2.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	Anëtar i		“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i		“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“	
Sokol Berberi	Anëtar i		“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i		“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“	
Admir Thanza	Anëtar i		“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 15.9.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura çështjen nr. 29/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ilir Velo, i përfaqësuar nga avokati Artan Hoxha, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar nga prokuror Hysen Keta, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 26, datë 1.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i vendimit nr. 173, datë 18.5.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr. 588, datë 19.12.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18/2, 27,30,32/2,42/2 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, 14 dhe Protokolli 12 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza; përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Bazuar në dosjen gjyqësore, rezulton se në datën 26.3.2006 i mituri V.GJ., në prani edhe të prindërve të tij, ka bërë kallëzim tek oficeri i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier se ndaj tij, rreth orës 12.00-12.30 të asaj dite, pranë shinave të trenit në lagjen “8 Shkurti” në Fier, është kryer krimi i marrëdhënieve homoseksuale me dhunë.

2. Referuar shkresës nr. 1404 prot., datë 10.4.2006 të komisariatit të policisë Fier, ky komisariat “*nga burime konfidenciale ka marrë të dhënën se në atë zonë, atë ditë në atë lagje dhe në ato orë është parë të lëvizte një shtetas homoseksual nga qyteti i Lushnjës. Në bazë të verifikimeve është identifikuar kërkuesi, i cili u shoqërua në komisariat si i dyshuar, dhe pas paraqitjes për njohje ai u njoh nga i dëmtuari si autor i kësaj vepre penale*”.

3. Pas paraqitjes për njohje të bërë në datën 27.3.2006, prokurori i çështjes ka urdhëruar ndalimin e kërkuesit, urdhër që është ekzekutuar menjëherë nga oficeri i policisë gjyqësore, në po atë datë në orën 20.00.

4. Në datën 28.3.2006 prokurori ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të mitur, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal.

5. Një ditë më pas, në datën 29.3.2006, prokurori ka kërkuar vlerësimin e ndalimit dhe të caktimit të masës së sigurisë në gjykatë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 77 datë 30.3.2006, mbi bazë të rezultateve të veprimit procedural të paraqitjes për njohje, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit duke caktuar si masë sigurimi personal atë të arrestit me burg.

6. Pas kryerjes edhe të një sërë hetimesh paraprake, prokuroria e dërgoi çështjen për gjykim, në përfundim të së cilit gjykatat dhanë vendimet e mëposhtme:

6.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 261, datë 1.12.2006, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit Ilir Velo për veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të mitur, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 18 vjet burgim.

6.2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 173, datë 18.5.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 261, datë 1.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

6.3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr. 588, datë 19.12.2008 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi ndaj vendimit nr. 173, datë 18.5.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

7. Kërkuesi pretendon se vendimet objekt kërkese i kanë cenuar të drejtën themelore për një proces të rregull ligjor për shkak të:

7.1. Cenimit të së drejtës themelore të lirisë dhe sigurisë personale, të sanksionuar në nenet 27-28 të Kushtetutës dhe në nenin 5 të KEDNJ-së, për shkak se është ndaluar në kundërshtim me ligjin;

7.2. Cenimit të së drejtës themelore për t'u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të sanksionuar në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së. Paraqitja për njohje është bërë në kundërshtim me nenet 6/1, 34, 53, 128, 151/4, 171, 172 , 246/1, 255/1, dhe 256 të Kodit të Procedurës Penale. Shkelja e këtyre dispozitave procedurale penale e bën nga pikëpamja procedurale këtë veprim/akt procedural një akt/veprim absolutisht të pavlefshëm dhe provën e përftuar prej tij një provë të papërdorshme, ndërsa nga pikëpamja kushtetuese një të dhënë të mbledhur në mënyrë të paligjshme.

7.3. Cenimit të së drejtës themelore për t'u prezumuar i pafajshëm, të sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës dhe në nenin 6/2 të KEDNJ-së, si pasojë e cenimit të parimit *in dubio pro reo*, çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Pamjaftueshmëria nga ana e gjykatës e shpjegimit dhe analizimit të provave materiale që mbartin një shkallë të lartë objektiviteti, tabulatet telefonike, e që sipas tij provonin vërtetësinë e alibisë së kërkuesit, rrëzimi pa shkaqe të arsyeshme nga ana e gjykatës e kërkesës së mbrojtësit të tij për ekspertim mjeko-ligjor mbi vetë kërkuesin, sugjerojnë në një farë mënyre se gjykata, bazuar në faktin e orientimit seksual të kërkuesit, e ka paragjykuar, qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme, atë si autor të veprës penale.

7.4. Cenimit të së drejtës themelore të barazisë para ligjit të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe në nenin 14 të KEDNJ-së, për shkak se kërkuesi është ndaluar, arrestuar, proceduar, gjykuar e më pas dënuar për veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të mitur, jo mbi bazën e vlerësimit të plotë e të gjithanshëm të provave, por nisur nga vlerësime diskriminuese, të bazuara mbi njohuritë për orientimin e tij seksual.

7.5. Cenimit të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6/1 të KEDNJ-së, për shkak se në një kohë kur gjatë procedimit dhe gjykimit kërkuesit i ishin mohuar një sërë të drejtash procedurale e kushtetuese, Kolegji seleksionues i Gjykatës së Lartë ka vendosur, në Dhomë Këshillimi, mospranimin e rekursit çka i ka mohuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas kërkuesit, ky vendim i Kolegjit të

Gjykatës së Lartë, duke mos verifikuar shkaqet e rekursit dhe duke mos arsyetuar shkaqet e mospranimit të tij, vjen në kundërshtim jo vetëm me vetë praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në këtë drejtim, por edhe me detyrimin e sanksionuar në nenin 142/1 të Kushtetutës se "*vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara*".

8. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtroi këto prapësime:

8.1. Pretendimi se shoqërimi dhe ndalimi i kërkuesit në komisariatin e policisë Fier është i paligjshëm dhe është kryer me qëllim diskriminimi nuk qëndron, sepse të gjithë veprimet e kryera nga policia gjyqësore janë në përmbushje të plotë me kompetencat e saj ligjore.

8.2. Pretendimi se paraqitja për njohje është bërë në kundërshtim me nenet 171-172 të Kodit të Procedurës Penale nuk qëndron. Pretendimi i kërkuesit se, përpara kryerjes së veprimit të paraqitjes për njohje, i është treguar paraprakisht kërkuesi (personi që do paraqitej për njohje), rrëzohet plotësisht nga procesverbali që pasqyron kryerjen e këtij veprimi, veprim që është verifikuar e vlerësuar me vëmendje prej gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit, në kuadrin e pretendimeve të kërkuesit, nga ku ka rezultuar se i dëmtuari i mitur e ka njohur kërkuesin si autor të veprës penale në dëm të tij.

8.3. Gjykimi i akuzës së ngritur kundër kërkuesit, si nga gjykata e shkallës së parë, edhe nga gjykata e apelit është bërë në respektim të plotë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha provat për çështjen janë shqyrtuar e vlerësuar në gjykatë së bashku me pretendimet e ngritura nga kërkuesi, të cilat janë verifikuar dhe vlerësuar në raport me gjithë provat e administruara. Nga materialet e çështjes rezulton se kërkuesi është deklaruar fajtor për akuzën e ngritur kundër tij, fajësi e cila është provuar nga një sërë provash si akti i ekspertimit mjeko-ligjor, procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes, procesverbali i paraqitjes për njohje, tabulatet telefonike, deklarimet e të dëmtuarit dhe të dëshmitarëve, prova këto që, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, janë marrë në përputhje me normat procedurale, parashikuar nga nenet 149-158 të Kodit të Procedurës Penale.

8.4. Fakti i prirjeve homoseksuale të kërkuesit detyrimisht do të evidentohej shpesh gjatë procesit penal për shkak të veprës penale për të cilin ai është akuzuar gjykuar dhe dënuar, por në asnjë rast ky fakt nuk është vënë në dukje apo përdorur me qëllim diskriminimi. Shkresa që komisariati i policisë Fier i ka dërguar Prokurorisë së Rrethit, të cilën kërkuesi e paraqet si provë, nuk ka asnjë nuancë diskriminimi. Kjo shkresë pasqyron përmbajtjen e një informacioni nga burime konfidenciale që detyrimisht duhet pasqyruar ashtu siç është dhënë nga burimi "*se në atë zonë, atë ditë në atë lagje dhe në ato orë është parë të lëvizte një shtetas homoseksual nga qyteti i Lushnjës*", informacion që ka rezultuar i saktë sepse prirjet homoseksuale të kërkuesit kanë qenë të njohura edhe nga persona të tjerë.

8.5. Pretendimi se vendimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, për mospranimin e rekursit i ka cenuar kërkuesit të drejtën themelore për një proces të rregullt ligjor nuk qëndron, sepse bazuar në nenet 432-433 të Kodit të Procedurës Penale, ky vendim është dhënë brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes nga kjo Gjykatë. Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi se vendimi i Kolegjit Penal nuk është i arsyetuar, ky vendim ka të shprehur qartë arsyen përse rekursi nuk pranohet dhe bazën ligjore mbi të cilën merret ky vendim.

II

9. Vlerësimi i Gjykatës

9.1. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë (Gjykata) referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe

juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*vendimi nr. 4, datë 28.2.2006 i Gjykatës Kushtetuese*).

Në vijim të këtij vlerësimi, Gjykata analizon më poshtë pretendimet e ngritura.

A. Mbi cenimin e të drejtës themelore të lirisë dhe sigurisë personale

10. Gjykata, lidhur me këtë pretendim, thekson se neni 27 i Kushtetutës ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet kur kufizohet liria. Në nenin 28/1 të Kushtetutës, parashikohet: "*Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet ... për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personit, të cilit i është hequr liria, duhet ...t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij*.". Një nga kushtet për të cilat mund të kufizohet liria e individit është rasti kur ka dyshime të arsyeshme se personi ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Lejimi i këtij kufizimi tenton të balancojë nevojën për të vepruar kundër veprave penale ndaj pretendimeve të lirisë personale që çdo individ normalisht ka, dhe që duhet të garantohet nëpërmjet procedurave ligjore.

11. Gjykata, referuar jurisprudencës së saj, çmon se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor mbi masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. E drejta e lirisë së individit dhe kufizimet e saj sanksionohen edhe në nenin 5/1, shkronja "c" të KEDNJ-së, sipas së cilës "*çdokush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj… kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent…"* si dhe paragrafit 4 ku parashikohet se *"çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ..... ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm*".

13. GJEDNJ-ja ka theksuar se "...Megjithëse nuk është e nevojshme gjithmonë që procedura sipas nenit 5/4 të KEDNJ-së, të realizohet me të njëjtat garanci si ato të kërkuara sipas nenit 6 për çështje penale ose civile, duhet që kjo procedurë të ketë karakter gjyqësor dhe të sigurojë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë ... . Për më shumë duhet të kemi në vëmendje, se neni 5/4 dhe neni 6, pavarësisht lidhjes së tyre, kanë qëllime të ndryshme. Neni 5/4 ka si qëllim mbrojtjen kundër burgimit arbitrar, duke garantuar procedura të shpejta. Në rastet e paraburgimeve, sipas nenit 5/1 (c), shqyrtimi konsiston në faktin nëse ka apo jo një dyshim të arsyeshëm mbi të arrestuarin." (*Reinprecht kundër Austrisë, vendim i datës 15 nëntor 2005*).

14. Gjykata referuar materialeve të dosjes gjyqësore vëren se kërkuesi gjatë gjykimit të zakonshëm ka ngritur pretendimin se pa u formalizuar proceduralisht arrestimi apo ndalimi i tij si dhe pa iu komunikuar akuza apo shkaku i ndalimit, pa iu bërë e njohur asnjë e drejtë, as e drejta për mbrojtje, kërkuesi i është nënshtruar veprimit procedural të "njohjes së personit". Ky pretendim, në vetvete, është i lidhur ngushtë dhe në mënyrë të pazgjidhshme me pozitën juridiko-procedurale penale të kërkuesit deri në momentin që mbi të ka vepruar urdhri i ndalimit i nxjerrë nga prokurori. Gjykata çmon se përcaktimi i kësaj gjendjeje është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për themelësinë e këtij pretendimi, kur për më tepër, referuar shkresës nr. 1404 prot., datë 10.4.2006 të komisariatit të policisë Fier, kërkuesi është shoqëruar në këtë komisariat si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të kallëzuar.

15. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, bazuar edhe në vendimin unifikues nr. 3 datë 27.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të mbante një qëndrim të

shprehur lidhur me këtë pretendim, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, është detyrë dhe funksion i kësaj Gjykate.

B. Mbi cenimin e së drejtës për t'u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

16. Gjykata në lidhje me këtë aspekt të procesit rikonfirmon jurisprudencën e saj se pranimi dhe vlerësimi i provave si rregull bëhet nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt. Gjykata, në qëndrimet e saj, ka evidentuar në një proces ligjor dallimin që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet, kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 95-2001, nr. 7-2005*).

17. Gjykata në rastin në shqyrtim konstaton se veprimi procedural "i njohjes së personit", i parashikuar nga nenet 171-172 të Kodit të Procedurës Penale, është prova bazë që lidh kërkuesin me veprën penale për të cilën ai akuzohet.

Gjykata bazuar në standardin e vendosur nga GJEDNJ-ja në çështjen Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, vlerëson se ligjshmëria e përftimit të të dhënës nëpërmjet këtij veprimi procedural është e lidhur ngushtë si me respektimin e të drejtës së mbrojtjes ashtu edhe me vetë procedurën e kryerjes së saj.

18. Në rastin në shqyrtim, e drejta e mbrojtjes së kërkuesit në lidhje me veprimin procedural "të njohjes së personit" rrjedh nga përcaktimi i pozitës juridiko-procedurale penale të tij përpara dhe gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural. Ndërsa procedura e kryerjes të këtij veprimi duket të jetë konform parashikimeve ligjore të neneve 171-172 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë gjykimit të zakonshëm, ka ngritur pretendimin se veprimi procedural "i njohjes së personit" është kryer si në shkelje të së drejtës së mbrojtjes ashtu edhe të parashikimeve ligjore të neneve 171-172 të Kodit të Procedurës Penale dhe për pasojë ky akt/veprim është absolutisht i pavlefshëm.

Gjykata e Lartë nuk është shprehur për këtë pretendim.

19. Në këto kushte, Gjykata, referuar rolit të Gjykatës së Lartë në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, çmon se ajo duhet të shprehej për qëndrimin e saj lidhur me pretendimin e mësipërm.

C. Mbi cenimin e së drejtës themelore për t'u prezumuar i pafajshëm

20. Gjykata Kushtetuese është shprehur edhe më parë se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 28.4.2004; nr. 23 datë 23.7.2009*).

21. Prezumimi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja (*shih vendimet e GJEDNJ-së Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001*), e cila ka theksuar se "prezumimi i pafajësisë është një nga

elementet e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6 par.2 të KEDNJ-së. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor, përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton të ekzistojë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja.

22. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë gjykimit të zakonshëm, ka ngritur pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm. Kërkuesi i është referuar një sërë fakteve hetimore dhe gjyqësore, si kryerjes së veprimit procedural të këqyrjes së vendit të ngjarjes gati 1 (një) muaj pasi kishte ndodhur vepra penale, përdorimit, sipas tij, në arsyetimin e vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë të shprehjeve që sugjerojnë paragjykim, pamjaftueshmërisë së shpjegimit dhe analizimit të provave materiale që mbartin një shkallë të lartë objektiviteti (tabulateve telefonike), rrëzimit pa shkaqe të arsyeshme të kërkesës së mbrojtësit të tij për ekspertim mjeko-ligjor mbi vetë kërkuesin. Këto pretendime nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë.

23. Gjykata vlerëson se edhe mbi këto pretendime të kërkuesit, të cilat përbëjnë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë nuk është shprehur.

D. Mbi cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si rrjedhojë e shkeljes se parimit të barazisë para ligjit

24. Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Respektimi i parimit të barazisë kërkon, ndër të tjera, mosdiskriminimin e shtetasve dhe grupeve, në kushte të njëjta, pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

25. Në vijim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në gjykimet për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, cenimi i parimit të barazisë në gjykim është i lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Prandaj Gjykata, pretendimin e kërkuesit për cenim të parimit të barazisë para ligjit, e analizon në këndvështrimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

26. Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk e ka argumentuar këtë pretendim në nivel kushtetues.

27. Në përfundim, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, thekson qëndrimin e saj se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Prandaj Gjykata e Lartë për pretendimet e ngritura nga kërkuesi duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, në funksion të rolit të saj në kontrollin dhe respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

28. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 588, datë 19.12.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me shumicë votash (*votuan kundër shfuqizimit të vendimit nr. 588, datë 19.12.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, gjyqtarët Xh.Zaganjori, P.Plloçi, V.Tusha dhe A.Xhoxha*j).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

- Rrëzimin për kërkimet e tjera, me shumicë votash (*votuan kundër rrëzimit, gjyqtarët B.Dedja, V.Kristo, S.Berberi dhe F.Hoxha*).

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha.

VENDIM
Nr. 16, datë 17.2.2012

MBI KAPACITETET E INTERKONJEKSIONEVE NË DREJTIMIN IMPORT-EKSPORT PËR MUAJIN MARS 2012

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "ç" paragrafi "ii" dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 7 germa "b" të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X të "Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike", të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a. dhe KESH sh.a. me nr. 807, prot., dhe nr. 642, prot., datë 10.2.2012 në lidhje me alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve në drejtimin import për një periudhë 3-4 mujore, u njoh me opinionin e OST sh.a. mbi këtë kërkesë, dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstaton:

- Mungesën e theksuar të reshjeve gjatë gjithë vitit 2011 dhe për periudhën në vijim, e cila reflekton një situatë të vështirë hidroenergjetike, me nivele shumë të ulëta të rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, si dhe basenet e tjera të hec-eve që operojnë në vendin tonë. Më datë 14.2.2012 kuota në basenin e hec-it Fierzë rezulton 259 metra.

- Moti me temperatura të ulëta është shoqëruar me një rritje të ndjeshme të kërkesës për energji elektrike dhe si të tillë, e nevojës për të importuar energji elektrike në pamundësi të plotësimit të kërkesës për energji të klientëve tariforë nga prodhimi vendas. Nga administrimi i të dhënave të marra në evidencën e dërguar nga OST, rezulton se konsumi për energji elektrike ka shënuar vlerën rreth 25 milionë KWh dhe si të tillë është rritur kërkesa për mbulimin e këtij konsumi nëpërmjet importit të energjisë elektrike nga vendet fqinje i cili aktualisht rezulton në vlerën rreth 10 milionë KWh.

- Rritja e kërkesës për energji elektrike dhe si të tillë e sasisë së energjisë elektrike për t'u importuar nga dy kompanitë bën që KESH sh.a. dhe "Cez shpërndarje" sh.a. të kenë nevojë për kapacitete të sigurta dhe të plota të kapaciteteve të interkonjeksionit në të gjitha linjat përkatëse të Shqipërisë me vendet fqinje për të siguruar furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve në vend.

- Më datë 12.2.2012 Këshilli i Ministrave vendosi shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit, në njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin e Librazhdit.

Për gjithë sa më sipër, me qëllim moscenimin e furnizimit pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve të energjisë elektrike (tarifore dhe te kualifikuar), Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Për muajin mars 2012, OST do të alokojë proporcionalisht kapacitetet e interkonjeksionit në drejtimin import-eksport, për mbulimin e kërkesës për energji elektrike nga klientët tariforë, përfshirë humbjet në sistemin e shpërndarjes, në masën 365 MW, dhe për mbulimin e kërkesës për energji elektrike nga klientët e kualifikuar në masën 40 MW, në përputhje me nominimet fizike të paraqitura në OST nga pjesëmarrësit e tregut sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 27, datë 15.3.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 952 PROT., DATË 23.2.2012 MIDIS "OST" SHA DHE "GSA" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës "V" të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa "A" pika 3, pikës 7 germa "g" të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.3.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 952 prot., datë 23.2.2012, midis OST sh.a dhe GSA sh.p.k.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a. dhe GSA sh.p.k. janë subjekte të licencuara nga ERE respektivisht me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.3.2009 "Për aktivitetin e transmetimit" dhe me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 102, datë 21.12.2009 "Për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar".

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, rregullat e tregut, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 146 datë 7.12.2011 "Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore".

- Modeli i Tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes me nr. 952, prot., datë 23.2.2012 të transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe GSA sh.p.k., me ndryshimet si më poshtë:

Pikat 5.14 përpunohen si më poshtë:

"Pika 5.14

Në rast kur GSA sh.p.k. nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a. ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës, të barabartë me 0.5 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera e vetë faturës.".

Pika 5.15 hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 28, datë 15.3.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HENZ ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET "DARSI 1", "DARSI 2", "DARSI 3"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa "a", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa "a", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Henz Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et "Darsi 1", "Darsi 2" dhe "Darsi 3.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 29, datë 15.3.2012

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S "GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE VEPRIMTARISË SË ERE-S GJATË VITIT 2011"

Në zbatim të neneve 9 dhe 10 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror" neni 13, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 15.3.2012, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s "Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2011", të paraqitur nga Kryetari i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s "Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2011", që do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.4.2012
Doli nga shtypi më 18.4.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë